

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6948
E enjte, 20 korrik 2023
Çmimi 0.40 €

Përkujtohet masakra
e Rahovecit në të cilën
forcat serbe patën vrrarë
150 civilë shqiptarë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ESCOBARI: NUK SHOH GATISHMËRI TË KOSOVËS DHE TË SERBISË PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË OHRIT



I dërguari amerikan për
Ballkanin Perëndimor, Gabriel
Escobar, ka thënë para
Komitetit për Punë të Jashtme
të Dhomës së Përfaqësuesve në
Shtetet e Bashkuara, se nuk

shih gatishmëri të Kosovës dhe
të Serbisë për zbatimin e
marrëveshjes së Ohrit.
Escobari u ka bërë thirrje
Kosovës dhe Serbisë të
angazhohen për zbatimin e


kësaj marrëveshjeje. Ai ka
thënë se aspirata më e lartë e
ShBA-së është që Kosova të
ketë ulëse në Bashkimin
Evropian, NATO dhe Kombet e
Bashkuara



Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA

**ELMI REÇICA, BEKIM
HAXHIU DHE HAJDAR
BEQA KANË IDENTITET
KOMBËTAR DHE
POLITIK, PO TI DEJONA
MIHALI, KU E KE?! | FAQE 6**

**ISH-SHEFI I
AKI-së DËNOHET
MBI 4 VJET BURGIM
PËR DËBIMIN E
SHTETASVE TURO
NGA KOSOVA | FAQE 3**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



**MBI 700 PERSONA TË BURGOSUR
PAS TRAZIRAVE NË FRANCË | F. 5**

**MPB-ja ME MËRGIMTARËT NË
AEROPORTIN E PRISHTINËS:
"FESTO ME ZEMËR, JO ME ARMË" | F. 5**

**PKD-JA: QEVERIA S'KA MË
KREDIBILITET, VENDI KA NEVOJË
PËR ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME | F. 7**

EKONOMI



**20 BIZNESE SUSPENDOHEN NGA
PLATFORMA 'SUPERPUNA' | F. 8**

**SINDIKATA E PUNËTORËVE
E SEKTORIT PRIVAT KËRKON
QË MOS TË DEKRETOHET LIGJI
PËR PAGËN MINIMALE | F. 8**

SPORT



**EHF-ja FALËNDERON FHK-në
PËR ORGANIZIMIN E KAMPIONATIT
EVROPIAN U19 | F. 10**

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mbi 700 persona të burgosur pas trazirave në Francë

PARIS, 19 KORRIK - Më shumë se 700 persona janë dënuar me burgim pas trazirave që ka përjetuar Franca në fund të muajit të kaluar, ka thënë ministri i Drejtësisë në Francë, Eric Dupond-Moretti. Sipas tij, në total janë shqiptuar 1 278 dënime dhe 96 për qind e tyre kanë pasur të bëjnë me akuzë për vandalizëm dhe sulm ndaj zyrtarëve policorë. Deri më tani është thënë se janë burgosur 600 persona. "Ka qenë jashtëzakonisht e

rëndësishme që ta kemi një përgjigje të qëndrueshme dhe sistematike", ka thënë Dupond-Moretti për radion RTL. "Ka qenë thelbësore që ta rikthejmë rendin kombëtar". Dhuna më e ashpër urbane në Francë, prej vitit 2005, ka nisur këtë vit më 27 qershor, pasi një zyrtar policor e ka qëlluar për vdekje një 17-vjeçar me prejardhje afrikane gjatë një kontrolli në trafik. Incidenti ka ndodhur në perëndim të Parisit dhe është

incizuar nga një këmbësor i rastit. Trazirat janë ndalur pas katër netëve të dhunës serioze dhe angazhimit të mbi 45 000 forcave të sigurisë, përfshirë njësitet speciale. Moshë mesatare e mbi 3 700 personave të arrestuar ka qenë 17, prandaj të miturit janë paraqitur në gjykata të ndara për fëmijë. Numri i personave të dënuar nëpër burgje e tejkalon shifrën e vitit 2005, kur janë burgosur rreth 400 persona.



Koreja e Veriut lëshon dy raketa si përgjigje ndaj nëndetëses amerikane

PHENIAN, 19 KORRIK - Koreja e Veriut lëshoi dy raketa balistike me rreze të shkurtër veprimi në Detin Lindor gjatë mëngjesit të së mërkurës si përgjigje ndaj vendosjes së një nëndetëseje amerikane që mban armë bërthamore në Korenë e Jugut. Shefat e përbashkët të Shtabit të Koresë së Jugut (JCS) thanë se midis orës 3:30 dhe 3:46 të mëngjesit Koreja e Veriut gjuajti dy raketa balistike me rreze të shkurtër veprimi nga një zonë pranë kryeqytetit Phenian. Ato fluturuan rreth 550 kilometra para se të binin në det në lindje të gadishullit korean.

Ushtria japoneze raportoi se raketat ranë jashtë zonës ekskluzive ekonomike të Japonisë dhe se deri tani nuk ka raportime për dëmtime të anijeve apo avionëve në atë zonë.

Nga JCS-ja i bën thirrje Koresë së Veriut t'i ndërpresë lëshimet e tilla. "Ne dënojmë fuqishëm lëshimet e njëpasnjëshme të raketave balistike të Koresë së Veriut dhe i shohim si akte të rënda provokuese që minojnë paqen dhe stabilitetin e gadishullit korean, si dhe komunitetin ndërkombëtar, dhe janë një shkelje e qartë e rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së", tha JCS-ja në një deklaratë për medie. Ushtria amerikane tha se ishte



në dijeni për këto lëshime të raketave dhe ishte duke u konsultuar ngushtë me aleatët dhe partnerët e saj. Gjatësia e fluturimit të raketave të Koresë së Veriut përputhet me distancën midis Phenianit dhe

qytetit të Koresë së Jugut, Busanit, ku nëndetësja amerikane USS Kentucky mbërriti të martën pasdite. Kjo është dërgesa e parë e një nëndetëseje amerikane të armatosur me armë bërthamore

në Korenë e Jugut që nga vitet 1980.

Më 12 korrik Koreja e Veriut testoi një raketë të re balistike ndërkontinentale me lëndë djegëse të ngurta, që tregoi se mund të arrijë potencialisht

thellë në kontinentin amerikan. Nisja u mbikëqyr nga udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, i cili është zotuar t'i forcojë më tej aftësitë bërthamore të vendit të tij përballë zgjerimit të aktiviteteve ushtarake mes ShBA-së dhe Koresë së Jugut.

Raketat u lëshuan në një kohë kur ShBA-ja dhe disa vende të tjera po përpiqen ta sigurojnë lirinë e një ushtari amerikan, që u arrestua një ditë më parë kur kaloi pa leje kufirin nga Koreja e Jugut për në Korenë e Veriut. "Një shtetas amerikan në një turne orientues kaloi, pa autorizim, vijën e demarkacionit ushtarak në Republikën Popullore Demokratike të Koresë", tha Komanda e OKB-së në "Twitter". "Ne besojmë se ai është aktualisht në paraburgim në Korenë e Veriut dhe po punojmë me homologët tanë për ta zgjidhur këtë incident", shtoi ai, duke iu referuar Ushtrisë Popullore të Koresë së Veriut.

Forcat e Koresë së Jugut dhe ShBA-së kanë kryer stërvitje ajrore dhe detare gjatë këtij viti. Vendosja e nëndetëses në ujërat jugkoreane është pjesë e përpjekjeve së Uashingtonit për t'iu përgjigjur më mirë kërcënimeve të Koresë së Veriut që kryen vazhdimisht testime të armëve bërthamore.

Kina dhe Rusia, gati për stërvitje të përbashkëta ushtarake detare

TOKIO, 19 KORRIK - Kina ka dërguar anije të marinës në përgatitje për stërvitjet e përbashkëta me forcat detare të Rusisë, në shenjë të mbështetjes së vazhdueshme të Pekinit për Moskën, në mes të luftës në Ukrainë.

Kina pretendon të jetë neutrale në konflikt, por e ka akuzuar

ShBA-në dhe aleatët e saj për provokim të Rusisë dhe ka mbajtur lidhje të forta ekonomike, diplomatike dhe tregtare me Moskën.

Agjencia e lajmeve shtetërore kineze "Xinhua" ka njoftuar se stërvitja përfshin më shumë se 10 anije dhe mbi 30 avionë.

Ministria e Mbrojtjes dhe

"Xinhua" nuk dhanë detaje, por stërvitjet besohet se do të zhvillohen në pjesë të Detit të Japonisë në ditët në vijim.

Kina e ka mbështetur Rusinë dhe ka kundërshtuar ShBA-në për pushtimin e Ukrainës në forumet ndërkombëtare por, megjithatë, ka thënë se nuk do t'i japë armë asnjëherë palë në luftë.



Përkujtohet masakra e Rahovecit në të cilën forcat serbe patën vrarë 150 civilë shqiptarë

PRISHTINË, 19 KORRIK - Presidentja Vjosa Osmani ka përkujtuar 25-përvjetorin e masakrës së Rahovecit.

Më 19 korrik të vitit 1998 forcat e regjimit gjenocidal të Serbisë vranë mizorisht 150 gra, fëmijë e pleq, të strehuar në Teqenë e Sheh Myhedinit në Rahovec, sikurse edhe në vendin e quajtur "Tuma". "Përkujtimi i sotëm nuk është vetëm një mundësi për ta kujtuar këtë ditë të trishtë, për ta kujtuar të kaluarën dhe për t'i nderuar viktimat, por mbi të gjitha është thirrje për drejtësi. Kujtimi për jetët e humbura e të pafajshme do të jetë i përhershëm, teksa zëri ynë për drejtësi do të kumbojë, deri në triumfin e saj!", është thënë në deklaratën e Osmanit. Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se më 19 korrik 1998 ushtria dhe policia serbe vranë, dogjën, plagosën, rrahën e maltretuan, morën peng dhe zhdukën me dhunë civilë shqiptarë të Rahovecit. "Ekzekutimet vijuan për disa ditë

me radhë. U masakruan edhe fëmijët, gratë dhe pleqtë që ishin strehuar në Teqenë e Sheh Myhedinit. Në përpjekje të fshehjes së krimeve, forcat serbe hapën dy gropa të mëdha në Rahovec dhe i hodhën një pjesë të shqiptarëve të vrarë gjatë kësaj masakre. Por nuk mund të zhduken e as harrohen krimet e kryera nga autoritetet e Serbisë urdhërdhënëse e ekzekutore", ka theksuar Kurti.

Ai ka shtuar se për dokumentimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe veprimeve gjenocidale të Serbisë, po themelojnë Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë. "Një zotim yni ndaj kujtesës sonë si popull dhe ndaj kërkesës sonë për drejtësi. Me angazhimin institucional për adresimin e të gjitha krimeve të kryera gjatë luftës në sistemin e drejtësisë vendore dhe ndërkombëtare, përkujtojmë 150 civilët e vrarë nga forcat serbe në masakrën e Rahovecit", është shprehur Kurti.




Edhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka përkujtuar masakrën e Rahovecit, duke theksuar se "përkulemi para sakrificës së qytetarëve duarthatë, të cilët u bënë cak i

barbarisë së pashembullt serbe. Ofensiva dhe masakra e ushtrisë serbe ishte hakmarrje për pamundësinë e ballafaqimit me ushtarët e UÇK-së, andaj zbrazi tërë mllëfin edhe ndaj qytetarëve

të pambrojtur e të strehuar në shtëpinë e Zotit, në Tyrben e Sheh Myhedinit dhe kudo nëpër Rahovec. Nderim i përjetshëm për dëshmorët dhe martirët e Rahovecit!"

Ish-shefi i AKI-së dënohet mbi 4 vjet burgim për dëbimin e shtetasve turq nga Kosova

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 KORRIK - Ish-shefi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Driton Gashi, është dënuar me katër vjet e tetë muaj burgim për dëbim të paligjshëm të gjashtë shtetasve të Turqisë që kishin leje qëndrimi dhe leje pune në Kosovë, në atë që njihet si rasti "Gylenistët". Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku iu shqiptua dënimi, u tha se Gashi shpallet fajtor për veprën penale "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar". Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, thuhet se Gashi ka keqpërdorur detyrën zyrtare duke

mos i përmbushur detyrat sipas kompetencës, duke rekomanduar revokimin e lejeve të qëndrimit dhe mosdhënien e lejes për njërin prej tyre, "për arsye se, kinse, ata paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, fakt që nuk është provuar fare në procedurë të zbatuar në bazë të ligjit". Në anën tjetër, nga akuzat janë liruar ish-drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Valon Ramadani, dhe ish-drejtori i Drejtorisë për Migracion dhe të Huaj në kuadër të Policisë Kufitare, Rrahman Sylejmani. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës më 24 shkurt 2021 kishte ngritur aktakuzë kundër

këtyre tre ish-zyrtarëve nën dyshimet për "keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe privimit të kundërligjshëm të lirisë". Aktakuza u ngrit pasi më 29 mars të vitit 2018, përmes një aksioni të gjerë të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, në orët e hershme të mëngjesit u arrestuan gjashtë shtetas turq. Dëbimi i tyre është thënë se është bërë përmes një aksioni të koordinuar ndërmjet shërbimeve të inteligjencës nga Turqia dhe Kosova. Arrestimit dhe dëbimit i parapriu revokimi i lejeve të tyre të qëndrimit, për të cilin veprim më vonë gjykata tha se ishte i jashtëligjshëm.

Nga pesë shtetasit turq, tre prej tyre posedonin leje të përhershme të qëndrimit, përkatësisht Mustafa Erdem, Yusuf Karabina, Karhaman Demirez, ndërsa dy prej tyre Hasan Hysein Demir dhe Cihan Ozkan kishin leje të përkohshme. Familjet e gjashtë shtetasve turq ngritën një padi ndaj institucioneve të Kosovës në vitin 2018 për arrestim dhe ndalim arbitrar të familjarëve të tyre. Disa nga familjarët kanë kërkuar azil në Kosovë e disa të tjerë janë larguar drejt vendeve evropiane. Gjashtë shtetasit turq të arrestuar në Kosovë dhe të dëbuar në Turqi në mars të vitit 2018 u dënuan nga gjykatat atje me gjithsej 56 vjet dhe 7 muaj e gjysmë burgim.

Gjykatat në Turqi shumicës prej tyre ua shqiptuan nga 8 vjet burgim, kurse njërit, Mustafa Erdem, drejtor i përgjithshëm i institucionit "Gulistan" në Kosovë, më 5 qershor iu shqiptua dënimi prej 15 vjetësh. Shkollat "Mehmet Akif" në Kosovë i përkasin Institutit Arsimor "Gulistan". "Gulistan" ka kopshte, institucione parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme në gjithë Kosovën. Besohet se ato janë të frymëzuara nga Lëvizja Hizmet e klerikut fetar turk Fethullah Gulen, të cilin presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, e fajëson për orkestrimin e përpjekjes për grushtshtet në Turqi në vitin 2016.



Escobari: Nuk shoh gatishmëri të Kosovës dhe të Serbisë për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit

I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë para Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara, se nuk shoh gatishmëri të Kosovës dhe të Serbisë për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit. Escobari u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë të angazhohen për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Ai ka thënë se aspirata më e lartë e ShBA-së është që Kosova të ketë ulëse në Bashkimin Evropian, NATO dhe Kombet e Bashkuara

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 KORRIK - I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se nuk shoh gatishmëri të Kosovës dhe të Serbisë për ta zbatuar Marrëveshjen e Ohrit, ndonëse ajo, sipas tij, ofron mundësi të jashtëzakonshme për të dyja vendet. Ai i ka bërë këtë deklaratë para Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara, teksa ka diskutuar për sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor dhe qasjen e Shteteve të Bashkuara ndaj këtij rajoni. “Ne kemi tentuar vazhdimisht t’i shtyjme të dyja palët që të veprojnë, dhe në kthim kemi parë disa seri të përshkallëzimit të situatës. Pozicioni ynë është se marrëveshja do të mund të zbatohet menjëherë pas arritjes

së pajtueshmërisë. Secila palë është dashur ta hartojë rrugën sesi do ta zbatonte atë”.

Kosova dhe Serbia kanë arritur pajtueshmëri, në shkurt të këtij viti në Bruksel, për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve. Më pas, në mars, në Ohër janë pajtuar për ankesin e zbatimit të marrëveshjes. “Marrëveshja i kërkon Serbisë ta njohë sovranitetin e Kosovës dhe integritetin e saj territorial. T’ia njohë simbolet kombëtare, flamurin, dokumentet qeveritare, diplomat, targat e makinave dhe ia ndalon Serbisë ta bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Kosovës i kërkohet ta zbatojë obligimin që e ka për formim të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ne besojmë që të dyja vendet duhet të angazhohen menjëherë në këto aspekte, pa

parakushte. Duhet të nisin ta kryejnë pjesën e tyre”, ka thënë Escobari.

Ai ka thënë se aspirata më e lartë e ShBA-së është që Kosova të ketë ulëse në Bashkimin Evropian, NATO dhe Kombet e Bashkuara.

I pyetur se çfarë po bën ShBA-ja që t’i bindë pesë shtetet e BE-së - Spanjën, Sllovakinë, Rumaninë, Greqinë, dhe Qipron - që ta njohin shtetësinë e Kosovës, Escobari ka thënë se është në kontakt të vazhdueshëm me to. “Marrëveshja e Ohrit na ofron neve mundësinë më të madhe në 15 vjetët e fundit që të bashkëpunojmë me Qeverinë e Kosovës që të niset jo vetëm një fushatë evropiane e njohjeve, por një fushatë globale e njohjeve. Shumica e shteteve do të dëshironin ta shihnin gatishmërinë e Kosovës që ta

përbushë pjesën e saj të marrëveshjes [së Ohrit], që është Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Kjo është një prej arsyeve pse e kam shtyrë Qeverinë e Kosovës ta çojë përpara këtë gjë - me mbështetjen amerikane - përmes një rruge që Asociacioni të mos e rrezikojë Kushtetutën, apo strukturën ligjore, që të mund ta nisim këtë vit fushatën e njohjeve. Deri më tani nuk e kam marrë atë zotim prej Qeverisë së Kosovës”, ka treguar Escobari.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Serbia kërkon që Kosova t’i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik. Mekanizmi ndërkombëtar i ka kërkuar Kosovës ta formojë Asociacionin në përputhje me Kushtetutën, duke ia përmendur disa modele që veçse ekzistojnë në botë.

Duke folur për situatën aktuale në Kosovë, ligjvënësit amerikanë i kanë konsideruar tensionet e fundit në veri si shumë alarmuese. Ata e kanë kritikuar edhe qasjen e Qeverisë së Kosovës dhe mungesën e koordinimit me ShBA-në, por edhe rolin e Serbisë në protestat në veri. Mirëpo, Escobari ka thënë se ka marrë zotime që Serbia nuk do t’i kundërshtojë zgjedhjet e ardhshme në veri të Kosovës dhe se Serbia do të përballet me pasoja nëse vepron ndryshe.

Tensionet në veri të Kosovës kanë qenë të larta që disa javë, sidomos në muajin qershor. Situata është përkeqësuar pasi serbët lokalë në komunat në veri të Kosovës - Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - kanë kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë me asistimin e Policisë së Kosovës në ndërtesat komunale. Kryetarët i kanë fituar mandatet në zgjedhjet e mbajtura në prill të këtij viti, të cilat i kanë bojkotuar serbët. Mirëpo, më 11 korrik Bashkimi Evropian ka konfirmuar se ka arritur marrëveshje me Kosovën me qëllim të uljes së tensioneve. Sipas BE-së, Kosova ka pranuar

MPB-ja me mërgimtarët në Aeroportin e Prishtinës: “Festo me zemër, jo me armë”

Prishtinë, 19 korrik - Në kuadër të fushatës “Festo me zemër, jo me armë”, të mërkurën është mbajtur aktiviteti i promovimit të fushatës me mërgimtarët që vinin përmes aeroportit ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë. Me këtë rast, koordinatori për Armë të Vogla dhe të Lehta, njëherësh zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, së bashku me një ekip nga Policia e Kosovës dhe zyrtarë të MPB-së, bashkëbiseduan dhe shpërndanë mesazhet kryesore të fushatës për parandalimin e gjuajtjeve festive.

Zëvendësministri Gashani kërkoi nga mërgimtarët që këtë mesazh për parandalimin e të shtënave festive ta ndajnë dhe me familjarët e tyre në Kosovë, sidomos në ambiente festive ku marrin pjesë për t'i njoftuar qytetarët mbi pasojat që vijnë nga të shtënat gjatë gëzimeve familjare. “Është e rëndësishme që në ahengjet tuaj të festoni pa të shtëna me armë. E shtëna me armë nuk është traditë, i përket të kaluarës, andaj ju ftojme të bashkëpunoni me Policinë e Kosovës në rastet kur jeni në ambiente ku ka prani apo të shtëna me armë. Me të gjithë aktorët institucionalë dhe të sigurisë po punojmë ngushtë që t'i parandalojmë të shtënat festive dhe ta rritim nivelin e sigurisë në vend”, ka theksuar



zëvendësministri Gashani. Ndërsa mërgimtarët që vinin në Kosovë e mirëpritën nismën e MPB-së për këtë fushatë dhe prematuan që të njëjtat mesazhe t'i ndajnë edhe me familjarët

dhe të afërmit e tyre. Ministria e Punëve të Brendshme më 30 qershor filloi zyrtarisht fushatën “Festo me zemër, jo me armë” me aktivitete në shkolla, takime me

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, institucionet e sigurisë, institucionet fetare dhe asamble komunale në qytete të ndryshme në Kosovë. Aktivitete të tjera do ta

përcjellin fushatën gjatë ditëve dhe muajve në vijim për ta ngritur ndërgjegjësimin e qytetarëve e për ta rritur numrin e raportimeve për të shtënat festive.

ta shkurtojë praninë e policisë në dhe rreth ndërtesave komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, dhe se Kosova do ta mbështesë mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore, si pjesë e veprimeve për ta shtensionuar situatën.

Qeveria e Kosovës ka thënë se të gjithë hapat do të “finalizohen brenda një periudhe dyjavore”. Escobari ka vlerësuar se në mesin e problemeve kyçe me të cilat përballet Ballkani Perëndimor janë: përparimi i ngadalshëm në demokratizim, korrupsioni, varësia nga burimet ruse të energjisë, politikat etno-nacionaliste, dezinformatat dhe ndikimi i dëmshëm prej jashtë. Escobari ka thënë se si Shqipëria ashtu edhe Maqedonia e Veriut i kanë hapur negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe se të dyja janë partnere solide për inkurajimin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Për t'i çuar përpara aspiratat për anëtarësim në BE, Qeveria e Maqedonisë së Veriut është e përkushtuar për ndryshimet kushtetuese për ta njohur pakicën bullgare. Ne e mbështetim fuqishëm këtë hap

të vështirë, por të nevojshëm, dhe jemi të angazhuar me Qeverinë e re të Bullgarisë, për t'u siguruar se ajo nuk do të ketë kërkesa të reja sapo Maqedonia e Veriut t'i përmbushë kërkesat e marrëveshjes ekzistuese”.

Ai ka thënë se integrimet evropiane dhe transatlantike janë thelbësore për ta zvogëluar ndikimin e aktorëve të dëmshëm në këtë rajon, siç janë Rusia dhe Kina, por edhe të aktorëve lokalë të korruptuar, që synojnë ta destabilizojnë rajonin dhe t'i pengojnë integrimet, duke e zgjeruar ndikimin e tyre. Escobari ka thënë gjatë dëshmisë së tij se Rusia e shtrin ndikimin në rajon përmes dy rrugëve: dezinformatave dhe energjisë. “Asgjë më shumë. Rusia nuk ofron tregti bilaterale, as nuk ofron ndihmë, as kapacitet për ndërtim, as mbështetje për reforma demokratike. Thjesht, e fut rajonin në kurth përmes varësisë energjetike. Prandaj, sa më shpejt që mund t'i ndihmojmë rajonit në zvogëlim të varësisë, qoftë përmes gazit të lëngshëm natyror, apo përmes energjisë së ripërtrishme, aq më shpejt do të mund ta luftojmë ndikimin rus në rajon”.

Ai e ka përmendur edhe

Kurti: Po nisim t'ua hapim rrugën zgjedhjeve të parakohshme në veri

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë Kosova ka nisur t'ua hapë rrugën zgjedhjeve të parakohshme në komunat në veri të Kosovës në kuadër të marrëveshjes së arritur me Bashkimin Evropian për uljen e tensioneve. Ai i është referuar pajtueshmërisë së arritur në mes të kryenegociatorit të

ndikimin që synon ta shtrijë Kina përmes investimeve.

“Ne ofrojmë alternativa për të ndërtuar qëndrueshmëri kundër këtyre ndikimeve”, ka thënë Escobari.

Duke e përshkruar situatën në Malin e Zi, Escobari ka thënë se është rikthyer momentum drejt të ardhmes evropiane të këtij vendi. Ai ka vlerësuar se zgjedhjet e fundit presidenciale dhe parlamentare kanë qenë të lira, paqësore dhe se votuesve u janë ofruar mjaft zgjedhje.

Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi dhe të dërguarit të BE-së për dialogun mes dy vendeve, Miroslav Lajçak, më 10 korrik në Bratisllavë. “Prej javës së kaluar e kemi zvogëluar praninë e Policisë së Kosovës për 25 përqind në tri ndërtesat komunale në veri. Tani kemi nisur t'ua

“Rezultati e ka forcuar synimin e Malit të Zi drejt integritetit dhe reformave që do të mundësojnë përparim”.

Escobari ka thënë se presidenti i entitetit të Republikës Serpska në Bosnjë-Hercegovinë, Millorad Dodik, vazhdon të jetë i fokusuar në shpërbërjen e Marrëveshjes së Dejtonit dhe Kushtetutës së shtetit. Marrëveshja e Dejtonit i ka dhënë fund luftës në Bosnjë në vitet 1990. “Veprimet e vazhdueshme anti-demokratike të Dodikut kërcënojnë

hapim rrugëve zgjedhjeve të parakohshme. Kosova është duke e zbatuar marrëveshjen e arritur me BE-në, në Bratisllavë, për shtensionim të situatës”. Para dy dite Kurti është takuar me Lajçakun në Kretë të Greqisë, dhe kryeministri ka thënë se palët kanë diskutuar për këtë temë.

stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin e shtetit dhe gjithë rajonit”, ka thënë ai.

Escobari ka thënë se ShBA-ja do të vazhdojë t'i vëzhgojë këto veprime dhe të kërkojë llogaridhënie nga të gjithë ata që e dëmtojnë Marrëveshjen e Dejtonit apo që e kërcënojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës.

Dodiku është i sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar.

Elmi Reçica, Bekim Haxhiu dhe Hajdar Beqa kanë identitet kombëtar dhe politik, po ti Dejana Mihali, ku e ke?!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Protestë e kushtëzuar, jo e dëshiruara. Pasi kopja e zbehtë e Mata Harit, spiune shembullore me peshë globale, Mimoza Kulari si spiune në politikë e lexuar që nga ditët e para u kap në flagrancë duke biseduar me Sllavkon dhe Radojciqin, reagimi ishte i fuqishëm. Kërkohej përgjegjësi për faktin se ajo bisedoi me dyshen e Lista Srpska në qershor të vitit 2022 në kohën kur Milan Radojciq kishte hyrë në listën e Zezë të ShBA-së në vjeshtë të vitit 2021 që nënkupton se Mimoza Kulari e kishte këtë informatë sikur që e kishte edhe shefi i saj, Albin Kurti. Në vend se të shkarkohej me urgjencë, filluan ta arsyetojnë të gjithë ata të partisë, hiç këtu një dy zëra të mekur që nuk dëgjoheshin as një metër larg. Spiunia amatore politike si mbrojtje e kishte Albin Kurtin duke deklaruar fillimisht se kryeministri nuk ishte në detyrë për këtë bisedë, kurse kjo i kishte treguar vetëm para katër muajve dhe, pas disa pyetjeve të KM dhe sqarimit të saj, gjërat flenë si më së miri; të gjithë po tregojnë, por partia dhe deputetët të besojnë Mimoza Kularin e arsyetuan disa "analistë" oborrtarë mercenarë dhe disa mbetje të Serbisë dhe Jugosllavisë, analistë jugonostalgjikë, pa identitet njerëzor dhe moral, por me identitet të qartë antikombëtar dhe anti UÇK-së. Zjarrin e ndezi në Kuvendin e Kosovës një rrugaç dhe frikacak kronik, pa asnjë të kaluar, por i veshur me pushtet dhe i ruajtur nga policia edhe kur të pshurë që e hodhi gurin - shishen me ujë dhe e fshehu dorën duke u strehuar prapa prapancës së togerit norvegjez i kontrabanduar si ministër i Mbrojtjes në Kosovë dhe pas disa fundeve të deputeteve. Në Ligjin për pagën minimale nuk u përfshinë veteranët e luftës së UÇK-së, prandaj u mbajtën brenda ciklit kohor prej 24 orëve protesta kundër aferës "Zdravo" dhe mospërfshirjes së veteranëve në këtë luftë. Qeveria kishte marrë përgjegjësi se lista e veteranëve do të kalonte nëpër filtrat e verifikimit, mirëpo për thujaja dy vjet e gjysmë nuk bëri asgjë në ndërkohë që po i sanksionon veteranët, edhe ata të vërtetët në ndërkohë që veteranët mashtues nuk kanë çka të humbin. Paramilitari i mercenarëve anti-UÇK, ministri i financave luajti rol shumë ndikues në këtë përjashtim, si urrejtës i luftës, ish të burgosurve politikë duke sajuar një rrenë, në gjerdanin e rrenave zinxhirore, për ta arsyetuar këtë poshtësi. Fillorë një sulm kundër gazetareve kinse ata e kanë zbuluar aferën "Zdravo" dhe se po i organizojnë këto protesta që qenkan kundër qeverisë dhe KM Kurti, aktualisht duke u rreshkur në ishullin e Kretës, duke i treguar përralla ish kryeministrit Papandreu për të kaluarën e tij si aktivist dhe opozitar. Këto që ia tregoi ish kryeministrit grek paraqesin interes të madh për politikën e jashtme të

Kosovës. Ndryshe, Kurti shkon në pushime pune në vendin mik të Kosovës dhe shtetit të parë që e ka njohur pavarësinë e Kosovës, Greqinë pra. Një ministër tjetër me role të shumta që ia kalon edhe Dr. Xhekillit dhe të cilin po i rri mbi kokë shpata që të shpallet persona non grata prandaj e ka paqësuar fjalorin duke e larguar cilësimin kriminelë dhe terroristë për "ushtarët" e Radojciqit, deklaroi se këta që po demonstrojnë dhe organizatorët po e bëjnë luftën hibride të Serbisë në Kosovë. Jam i sigurt që as që e di se çfarë është lufta hibride, e ka ngatërruar me miellin hibrid apo përzierje e kokainës, sheqerit me kristal sikur edhe për llojin e specave hibrid të somborkave. Të deklarosh se këta që e bënë luftën e lavdishme çlirimtare, pjesë e së cilës ishte edhe vet (po thonë 10 ditë të plota), mjaftueshëm të fitoni statusin e veteranit, është non sense sepse, për inate politike dhe në përpjekje ta mohoni luftën e të tjerëve po e mohoni edhe luftën tuaj, qoftë kjo edhe vetëm 10-ditore. Fati i luftës nuk përcaktohet me afate kohore, mund të luftoni dhjetëra vjet dhe të mos fitoni atë që e synoni sikur kurdët p.sh. mirëpo, nëse bëni luftë të mençur, 10 ditë janë tepër shumë për arrijtjen e qëllimeve, mund ta bëni edhe për një ditë të vetme. Nejsë, u kërkua dorëheqja edhe e këtij ministri mirëpo Albin Kurti, në mandatin e dytë qeverisë nuk e largon askënd nga pozita, pavarësisht përgjegjësisë që e ka. Aq më parë që Mimoza Kulari mund të ketë shumë çka të thotë nëse mbetet pa post e mos të flasim për këta dy dhe ministra tjerë që, me të dhënat që i kanë gëzojnë imunitet nga çdo ndjekje politike që eventualisht do ta pësonin. Shohim e bëjmë. Pas protestës ku, do të ishte jonormale të mos mermin pjesë ish-ushtarët e UÇK-së, ish të burgosurit politikë dhe të përndjekur nga baballarët dhe majkat e pjellës së sotme politike që, në emër të VV-së (asnjëherë nuk kanë qenë e as që janë VV) kanë metastazuar në të gjitha institucionet; qeveri, presidencë, Kuvend, Universitet, borde, ndërmarrje publike, diplomaci dhe në mendermethënë Akademi, sigurimsja e VV-së, Dejana Mihali, me një postim jonormal përqeshi protestën duke theksuar tre emra; Elmi Reçica, Hajdar Beqa dhe Bekim Haxhiu, si emra të përveçëm dhe duke rekomanduar që të protestojnë sa më shpesh në mënyrë, siç thotë kjo Beria e VV-së: "Ti njohë popullin...". Në mungesë elementare të etikës njerëzore kjo kosovare e natyralizuar nga komandantja supreme e forcave të armatosura të Ukrainës dhe në mënyrë fakultative presidente e Kosovës, përqesh me vuajtjet, burgjet, luftën, plagët, mungesën e gjymtyrëve të atyre që nga zori, në temperatura mbi 36 gradë u detyruan të protestojnë, me moshë të shtyrë dhe me shëndet të rrënuar. Përmes këtyre tre emrave të përveçëm po e sulmon luftën e lavdishme të UÇK-së dhe të gjithë ata që, në një mënyrë apo tjetër kontribuuan për këtë liri nga kjo endacake vetëm sa po përfiton, materialisht në radhë të parë pa e derdhur asnjë pikë djersë, si në

Shqipëri, ashtu në Kosovë. Në Kosovë ka kontribuar në shtimin e dhunës dhe humbjen e jetës së aktivistëve duke i helmuar me ide të cilat janë braktisur si nga ajo ashtu edhe nga Grupi Anarkist i Tiranës. Kjo krijesë, vetëm anatomikisht në formë njerëzore, nuk e pati as ndjenjën më të vogël të keqardhjes as për Bajram Qerkinin, 82-vjeçar, i lodhur por asnjëherë i dorëzuar para kërkesës për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur në mesin e të cilëve është edhe djali i Bajram Qerkinin. Ky është fundi i një pusi ku morali nuk e ka as kuptimin e përshkruar në fjalorin e gjuhës shqipe.

Ibe Palikuqi (Palikuka), Shkurte Pal Vata, Dejana Mihali dhe Grupi Anarkist i Tiranës: Grupi i Anarkistëve të Tiranës që e kanë pushtuar VV-në janë: Hysamedin Feraj, një kosovar që jeton dhe punon në Tiranë, Elvis Hoxha një kimist i filozofuar që jeton në Tiranë, Dejana Mihali një agjitprope nga Tirana dhe Bojken Abazi nga Tirana, i dështuar në Mjaft dhe i rilindur në VV. Këta nuk kanë lënë asnjë shenjë në Shqipëri ndërsa në Kosovë vetëm dëme kanë bërë duke manipuluar me analfabetët funksionalë të VV-së. Ndonëse ishin në moshë që mund të kontribuonin për luftën në Kosovë, hiç këtu Bojkenin që ishte 16 vjeç, Hyska ishte 36 vjeç, Elvsi 26 vjeç ndërsa Dejana 18 vjeçe nuk bënë gjë prej gjeje kurse sot shesin moral duke i sharë dhe stigmatizuar ata që e dhanë çdo gjë që kishin, vet dhe familjarisht për këtë liri ashtu si ekemiku, pa asnjë meritë gëzojnë të mira materiale pikërisht këta keqbërës ideologjikë. Ibe Palikuqi nga Dibra ishte vetëm 17 vjeçe kur ra në luftë për çlirimin e Kërçovës kurse Shkurte Pal Vata nga fsh. Pecaj i Dukagjinit ishte vetëm 14 vjeçe kur humbi jetën tragjikisht në trasenë për ndërtim të hekurudhës Rrogzhihë - Fier. Pas vdekjes së saj, u pranua si anëtare e Partisë së Punës së Shqipërisë dhe regjimi i atëhershëm tmerrësisht manipuloi me vdekjen e saj sikur që ky Grupi Anarkist nga Tirana kanë manipuluar dhe po manipulojnë me vdekjet - vrasjet tragjike të aktivistëve të VV-së. Dejana Mihali për mua është e njohur që nga fillimi i protestave të VV-së kur si komisarë politike dhe urith mbledhte informata të cilat pastaj i përdorte për diferencim të jomendimtarëve apo avancim të bythëlëpirësve të cilëve, që nga fillimi ua shkruante, kontrollonte apo redaktonte postimet. Na patën çarë pr...nicën me: "Jo negociata, Vetëvendosje", "Bashkim kombëtar", "Flamurin kombëtar dhe kundër flamurit të Kosova petrollit", për shkatërruesit e shtetit në periudhën 20-vjeçare në kohën kur po këta e shpallën pavarësinë e Kosovës, ndërtuan infrastrukturë rrugore më të mirën në rajon, siguruan mbi 100 njohje ndërkombëtare, e shtrinë pjesërisht ndikimin institucional në veri të Kosovës, rregulluan me ligj statusin e të gjithë atyre që në një mënyrë apo tjetër kontribuuan për lirinë e Kosovës, e krijuan një siguri sociale për shtetasit e cenuara etj. Të gjitha këto u arritën në kohën kur Kosova nuk ishte shtet i pavarur (deri në vitin 2008) sikur edhe në kohën kur kjo pavarësi ishte e mbikëqyruar gjë

që qeveria aktuale nuk i ka këto situata. Qeveria aktuale e ka trashëguar një kornizë të konsoliduar të quajtur shtet dhe vetëm duhet ta mbushë me përmbajtje. Me një fjalë, e ka shumë më lehtë se që e kishin ata para tyre. Çdo periudhë e proceseve historike i kërkon njerëzit që i duhen; Rugova kishte kuptim deri në vitin 1996 kur pas Konferencës në Dejtton, Kosova si e përjashtuar nga kjo konferencë hyri, jo me dëshirën e saj në një rrugë ku lufta mbeti si e vetmja mundësi për arrijtjen e lirisë. Erdhi koha e Hashim Thaçit dhe e Ushtrisë Çlirimtare së Kosovës që u fuqizua me luftën dhe sakrificën e jashtëzakonshme të Adem Jasharit, familjes Jashari dhe të gjithë luftëtarëve të UÇK-së. Në periudhën e shtetndërtimit gjithashtu Hashim Thaçi ishte faktori përcaktues bashkë me ata që e bënë luftën. Pas një periudhe 20 vjeçare kërkohej ndryshim dhe forcë e re politike për t'i çuar para proceset politike dhe shtetërore. Ishte koha e Albin Kurtit që fitoi mbi 50% të votave apo konsensusin e nevojshëm për vendimarrje, pa pasur nevojë për partitë tjera apo, siç i cilësuan në VV, "shkatërrues të shtetit". Albin Kurti është ende në pushtet. Unë, në kohët më të vështira për VV-në dhe Albin Kurtin i kam përkrahur me të gjitha mjetet dhe pa asnjë rezervë sepse i kam besuar Albinit. Tash, nuk e kam besimin e mëparshëm por e përkrahi çdo punë të mirë që do ta bëjnë mirëpo, së paku deri më tani janë e kundërta e të bërit punë të mira. E kanë instaluar mosbesimin ekstrem, injorancën, dëgjueshmërinë dhe përzgjedhjen krejtësisht në baza të mbrapshta të kadrove me të gjitha mjetet e lejuara dhe të palejuara po i sulmojnë të gjithë ata që kanë kontribuar për liri dhe fuqizim të VV-së ndërsa ndaj çlirimtarëve që po mbahen peng në Burgun Racist në Hagë kanë qëndrim denoncues, racist dhe sadist. Sidomos Grupi Anarkist i Tiranës. Sidomos Babushka ideologjike e VV-së, Dejana Mihali që kërkon që populli t'i njeh Elmi Reçicën, Bekim Haxhiun dhe Hajdar Beqën të cilët kur Grupi Anarkist i Tiranës shijonte jetë të rehatshme në Tiranë; Elmi Reçica mbajti 10 vjet burg politik, që nga ditët e para u bashkua me radhë e UÇK-së, deri në fund të luftës ku edhe u plagos ndërsa Bekim Haxhiu dhe Hajdar Beqa gjithashtu ishin ushtarë të UÇK-së që nga ditët e para dhe që të dy u plagosën gjatë luftës në kohën kur Dejonës dhe të tjerëve nuk iu kishte hyrë as edhe një therë e vetme në këmbë apo në ndonjë pjesë tjetër të trupit. E tash, merreni me mend kur këta tre dezertorë dhe mosdashës ta ndihmojnë luftën çlirimtare i gjykojnë ata që ishin të gatshëm të vdesin për liri të shqiptarëve dhe çlirim të Kosovës. Ky është fundi i mjerimit, njerëzor, moral dhe kombëtar nëse këtu kombëtarja zë vend! I përmenda këta tre emra sepse kështu mendoj për të gjithë ata që luftuan në radhë e UÇK-së, ishin të burgosur politikë apo kontribuuan për liri, çlirim dhe pavarësi. Kështu mendoj edhe për Gani Krasniqin dhe Sali Zybën që luftuan pa hile dhe pa interes. Këtu

ishin edhe Xhelal Sveçla, Liburn Aliu dhe Hysen Durmishi. Dikush po i quan edhe dezertorë. Nuk e di që në radhë e VV-së sot ka luftëtarë tjerë të UÇK-së, ishte Aida Dërguti por që e diferencuan. Por e di se në radhë e VV-së sot ka dëshmitarë të mbrojtur të Gjykatës Speciale, të tillë që kanë ikur nga lufta dhe, me të rënë në duart e policisë serbe kanë dhënë të gjitha informatat e mundshme për lokacionet dhe bashkëluftëtarët e tyre që sot përdoren edhe në Gjykatën Speciale. Këtu përfundon morali dhe e drejta për të akuzuar të tjerët në kohën kur asgjë nuk keni bërë për luftën, popullin dhe shtetin. Përveç se keni bërë keq dhe vazhdoni të bëni keq duke i përçarë qytetarët. Grupi Anarkist i Tiranës duhet të rri aty ku e kanë vendin dhe shfrytëzuar në mënyrë krejtësisht të pamoralshme të mirat materiale nga Kosova që me asgjë nuk i meritojnë. Kohë më parë, nga një person i lozhës bashkëpunuese me Serbinë dhe kundër shqiptarëve pati deklarata se Adem Demaçi nuk ishte asnjë ditë të vetme në burg dhe se ishte spiun i UDB-së. Nuk pati asnjë reagim institucional, as nga Kurti e as nga Konufca që po i palos blloqet në xhirollogari, kurse Vojsa Osmani sigurisht se do ta nënshkruante atë deklarata. Nëse për Bacën Adem Demaçi thuhet aso poshtërsi, nuk ka regjime institucionale, pse atëherë të çuditemi që një hiçmosgjë si Babushka ideologjike e VV-së të deklarojë siç po deklaroi për luftëtarët e UÇK-së dhe kontribuuesit e tjerë për liri dhe pavarësi. Kosova po përballtet me probleme ekzistenciale shtetërore dhe me varfërim galopant. Incidenti në Kuvend të Kosovës, me rrugat Bislimi në krye, e relativizoi aferën "Zdravo".

Të shohim nëse ky farë Bislimi do ta gjuajë bashkërrugaqin Lajçak me shishe apo do t'i lëshojë brekët para tij siç i ka lëshuar para çdo takimi. Le të vazhdojnë shpërkallëzimin e eskalimit të pordhëzuar me qëllim të vetëm që të mbesin në pushtet. Fillimisht me minus 25 % policë në veri e që pas zgjedhjeve do të jetë minus 90%, le të mbajnë zgjedhjet lokale në këto komuna ku Oso Kukën e Leposaviqit do ta nxjerrin në rrugë, le ta formojnë Zajebnicën, të lidhin marrëveshjen me Kishën ortodokse të Serbisë dhe pastaj i thërret Blinkeni. Shpejt do të bindin. Nuk është çështja nëse do të përmbushen këto kushte por si të ambalazhohen si domosdoshmërisht të këqija por më të mira se ato të "shkatërruesve të shtetit". Kosova është para problemeve të mëdha që lehtësisht do të shkaktojnë ngatërresa të mëdha midis vet shqiptarëve. Hajt tash Babushka e VV-së, mbushi armët me pordhë për ta luftuar Zajebnicën, për ta bërë bashkimin kombëtar, ngri lart flamurin e Kosovapetrollit dhe shkele flamurin e Ismail Qemalit për ta shtrirë sovranitetin në Madagaskar dhe për ta ruajtur integritetin territorial të Muçibabës! Sa të ketë budallenj, do të jetosh për shtat palë qejfe. Një përhëndetje që e donë dhe e admiron ti dhe bashkë-mendimtarët tuaj e që do t'ju përcjellë deri në ferr: ZDRAVO!

Shtohen kërkesat e qytetarëve shërbime në Klinikën e Gastroenterologjisë me Hepatologji

PRISHTINË, 19 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, në kuadër të vizitave në klinikat e ndryshme në QKUK, ka vizituar Klinikën e Gastroenterologjisë me Hepatologji. Nga drejtoresha e kësaj klinike, dr. Fitore Komoni, ministri Vitia u njoftua se në Klinikën e Gastroenterologjisë me

Hepatologji janë shtuar kërkesat e qytetarëve për të marrë shërbime. Sipas raportit të punës, gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti janë realizuar 1 033 gastroskopi dhe 709 kolonoskopi. Ministri Vitia ka thënë se Ministria e Shëndetësisë mbetet e angazhuar të krijojë parakushte sa më të

favorshme për qytetarët që marrin shërbime në institucionet publike. Ai ka kërkuar nga stafi udhëheqës që t'i adresojë të gjitha kërkesat të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, sidomos në rastet kur kërkesat për diagnostikim dhe trajtim të pacientëve janë më të shpeshta.



PDK-ja: Qeveria s'ka më kredibilitet, vendi ka nevojë për zgjedhje të parakohshme

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka mbajtur një takim të përbashkët në mes të kryesisë së partisë dhe grupit parlamentar të PDK-së. Në këtë takim u diskutua për zhvillimet e fundit politike në vend, respektivisht krizën politike e cila erdhi si pasojë e veprimeve të papërgjegjshme dhe të fshehta të Qeverisë së Kosovës.

Prishja e raporteve me miqtë ndërkombëtarë, vendosja e sanksioneve ndaj Kosovës, bashkëpunimi me kriminelin Milan Radojçiq dhe Listën Serbe, takimet dhe vendimet e fshehta në dëm të interesit nacional - janë disa prej shkaktarëve të cilat kanë bërë që kjo qeveri ta humbasë tërësisht kredibilitetin e saj.

Gjatë këtij takimi Krasniqi, kryesia e partisë, deputetët e grupit parlamentar, dënuan edhe një herë provokimin dhe dhunën e qeverisë ndaj deputetëve të PDK-së, të shkakuar në seancën e Kuvendit, të enjten më 13 korrik.

Sipas kryetarit Krasniqi, i gjithë ky orkestrim i qeverisë ndodhi për ta tërhequr vëmendjen nga skandali më i madh politik në vendin tonë në të cilin janë përfshirë ata vetë - koordinimi, bashkëpunimi dhe planifikimi i veprimeve politike bashkë me



kriminelin Milan Radojçiq, në dëm të shtetit dhe qytetarëve të Kosovës. Me këtë rast, kryetari Krasniqi, kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës dhe deputetët e grupit parlamentar njëzëri kërkuar zbardhjen e të vërtetës e cila fshihet prapa përgjimeve të cilat dëshmojnë bashkëpunimin e fshehtë të qeverisë Kurti me Radojçiqin

dhe Listën Serbe. Ata theksuan se PDK-ja nuk do të ndalet për asnjë moment, derisa e vërteta e plotë e koketimit të kësaj qeverie me kriminelin Radojçiq të merret vesh plotësisht.

PDK në këtë mbledhje ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të tregojë se çfarë po ndodh edhe me situatën në pjesën veriore të Kosovës. "Pse lëshoi

pe qeveria dhe pranoi të tërhiqet nga pjesa veriore, pas disa muajve të tensionit dhe detyrimit të aleatëve tanë që t'i vënë sanksione Kosovës? Pse u liruan kriminelët serbë të arrestuar për sulmet ndaj gazetarëve dhe KFOR-it? Për të gjitha këto veprime dhe takimet e fshehura dhe të paparalajmëruara të zyrtarëve

të Qeverisë së Kosovës me ata të Serbisë dhe të Bashkimit Evropian, PDK-ja kërkon transparencë dhe llogaridhënie të plotë. Gjithsesi, duke parë se kjo qeveri nuk ka më asnjë lloj kredibiliteti për të qeverisur vendin, PDK-ja konsideron se zgjidhja e vetme për ta larguar Kosovën nga kjo rrugë e shkatërrimit të çdo gjëje që është arritur në vitet e lirisë e të shtetësisë, është mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme të parakohshme sa më parë. Formimi i një qeverie të re që do ta kthejë Kosovën në binarët e rrugës euroatlantike është jetike për vendin dhe të ardhmen e qytetarëve tanë. Vetëm duke rivendosur e forcuar aleancat ndërkombëtare e forcojmë edhe shtetin tonë", është thënë në komunikatën e PDK-së.

Në fund të këtij takimi kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, njoftoi anëtarët e kryesisë dhe deputetët e grupit parlamentar për vizitën zyrtare që kishte në Paris dhe Bruksel, ku takoi shumë miq dhe aleatë të vendit tonë. Në të gjitha këto takime Krasniqi ka potencuar se veprimet e qeverisë nuk janë vullnet i qytetarëve të Kosovës dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e tyre. Në këtë kontekst, Krasniqi ka kërkuar që Kosova dhe qytetarët tanë, si vendi dhe populli më proevropian në rajon, të mos ndëshkohen me sanksione për shkak të kësaj kryeneqësie politike të një individi.

Berisha: U arrestova sepse e kam goditur pushtetin me një skandal

Prishtinë, 19 korrik - Avokati Besnik Berisha në një konferencë për medie ka zbardhur hollësi për arrestimin e tij të cilin e ka quajtur si një prej më skandalozin.

Avokati Berisha ka deklaruar se nuk ka kryer asnjë krim, por që është sanksionuar për një emision televiziv, ku ka zbuluar hollësi tronditëse

nga një skandal i qeverisë. "Jam këtu t'ju them se Besnik Berisha nuk ka kryer asnjë krim. Besnik Berisha është sanksionuar për një emision televiziv ku kam goditur pushtetin për një skandal që e keni dëgjuar edhe vetë. Pra për një betejë që shteti po përpiket ta maskojë embargon që është duke përjetuar e që unë e

kam denoncuar", ka thënë ai. Sipas Berishës, deklarata e tij i ka paraprirë urdhëresës për bastisjen e njëres nga pronat e tij kurse, siç ka thënë ai, prokurori kundërligjshëm ka urdhëruar arrestimin e tij. Avokati Berisha ka theksuar se për privimin nga liria të një avokati ka të drejtë vetëm një gjyqtar.



20 biznese suspendohen nga platforma "Superpuna"

PRISHTINË, 19 KORRIK - "Superpuna" ka njoftuar se 20 biznese janë suspenduar nga platforma si rezultat i mosrespektimit të termeve dhe kushteve të platformës të cilat janë vërejtur gjatë monitorimit në terren të përfituesve. Përkatësisht, gjatë monitorimit në terren të këtyre bizneseve monitoruesit kanë vërejtur që punëtorët të cilët figurojnë si

të punësuar në ato biznese, nuk kanë qenë të pranishëm në vendin e punës. Me këtë rast, 'Superpuna' ka suspenduar profilet e këtyre bizneseve duke ua pamundësuar të përfitojnë sërish nga subvencioni. "Qeveria mbetet e përkushtuar në mbështetjen e sektorit dhe fuqizimin e të rinjve në tregun e punës, megjithatë shkeljet e tilla të

Termeve dhe Kushteve do të pasohen me suspendim nga platforma. Monitorimi i bizneseve përfituese nga platforma 'Superpuna' është i rregullt dhe i vazhdueshëm. Andaj, udhëzojmë bizneset t'u përmbahen detyrimeve të tyre, ashtu që në vazhdimësi të kenë mundësinë të përfitojnë nga politikat mbështetëse të qeverisë", ka njoftuar "Superpuna".



Hajdari thotë se nuk është në dijeni se po hetohet për keqpërdorim të rezervave shtetërore

PRISHTINË, 19 KORRIK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka deklaruar se nuk është ftuar nga Prokuroria e Shtetit lidhur për rezervat shtetërore. Ajo shtoi se nuk është në dijeni nëse është në hetime apo jo. "Unë nuk jam ftuar asnjëherë nga askush për asgjë. Nuk e di që jam në hetime", tha Hajdari. Mediet raportuan se Hajdari po hetohet nga Task-Forca,

nën dyshimin për keqpërdorim të detyrës zyrtare për shkak të keqpërdorimit të rezervave shtetërore, përkatësisht në lidhje me blerjen e miellit dhe vajit, për të cilat është dëmtuar buxheti i shtetit. Task Forca Anti-korrupsion në Policinë e Kosovës, aktualisht është duke hetuar së paku pesë ministra dhe një zëvendësministër të qeverisë së Albin Kurtit.



Sindikata e Punëtorëve e Sektorit Privat kërkon që mos të dekretohet Ligji për Pagën Minimale



Prishtinë, 19 korrik - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, i ka bërë thirrje presidentes Vjosa Osmani që mos ta dekretojë Ligjin për Pagën Minimale. Në një njoftim për medie janë dhënë arsyetimet se përse nuk duhet të dekretohet ky ligj. Në letrën dërguar presidentes, Sindikata e Punëtorëve e Sektorit Privat ka renditur katër pika. "1. Nuk është përfill propozimi i KES, gjegjësisht Neni 9 alineja 19. 2. Nuk është përfillur vendimi i komisionit të grupit parlamentar për buxhet dhe financa, i cili i ka propozuar Parlamentit të

Kosovës që paga minimale për vitin 2023 të jetë 450 euro, kurse për vitin 2024 të jetë 500 euro. 3. Paga minimale është kosto e 4 anëtarëve të të punësuarit, e kjo pagë shpesh nuk e mbulon as vet punëtorin. 4. Është paga më e ultë në rajon", është bërë me dije në komunikatën e Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat. Deri më tani projektligji ka kaluar disa faza të rëndësishme. Ai është miratuar në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës më 14 qershor 2022, ndërsa më 13 korrik 2023 ai është miratuar edhe në lexim të dytë në Kuvend.

Punimet në rrugën Prizren - Prevallë po ecin me ritëm të shpejtë

Prishtinë, 19 korrik - Kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije se punimet në segmentin e rrugës Prizren - Prevallë tani po ecin me ritme

të shpejta. Ai ka thënë se është duke u punuar intensivisht për asfaltimin e këtij aksi të rëndësishëm. "Asfaltimi i projektit 'Rikonstruimi i

rrugës R-115', segmenti i rrugës Prizren - Prevallë, është kontratë që ka dy lote: Lot 1 - Me gjatësi të rrugës prej 16 km, dhe me vlerë të kontratës

rreth 8.4 milionë euro; si dhe Lot 2 - Me gjatësi të rrugës prej 10 km dhe me vlerë të kontratës rreth 7 milionë euro", ka thënë Kurti.



Agjenti i dyfishtë i Luftës së Ftoftë: Si e mashtroi Tito, Perëndimin?



Recenzion i Noel Malcolmit për librin *Tito's Secret Empire*, të autorëve William KLINGER dhe Denis KULJIŠ Përktheu: Daut DAUTI

Tito's Secret Empire (Perandoria sekrete e Titos) ka shpalosur mënyrën se si ai e drejtoi nga larg, një rrjet të agjentëve komunistë, derisa shfrytëzonte ndihma të mëdha nga Amerika.

Historia, siç dihet, shkruhet nga fituesit – veçanërisht kur ata janë komunistë. Mënjanimi i fakteve të padëshiruara është lojë fëmijësh e sunduesve që janë të kënaqur t'a heqin qafe popullin në shkallë masive. Dhe, kështu, një gjeneratë pas rënies së bllokut sovjetik, historianët ende orvaten që t'i ç'montojnë të gjitha tregimet që i kanë rrefyer komunistët.

Josip Broz Tito, sunduesi i Jugosllavisë nga viti 1945 e deri më 1980, ka qenë fitues i dyfishtë. Fitorja e tij e parë ishte ajo e udhëheqësit të rezistencës në Evropën që po lindte në fund të Luftës së Dytë Botërore, ku ai ishte në krye të një armate me qindra mijëra ushtarë dhe në kontroll të një pjese të madhe të vendit të tij. Fitorja e dytë ka qenë morale: pas ndarjes me Stalinin në vitin 1948, Tito u konsiderua si burrështetas i guximshëm, i pavarur dhe që u ngrit kundër bulizmit sovjetik. Nëntitulli i këtij libri është *How the*

Maharaja of the Balkans Fooled the World (Si e mashtroi botën maharaxha i Ballkanit), kështu që lexuesit presin një demolim serioz të mitit. Mbi të gjitha, 'mashtrimi' paraqet qëndrimin e Titos që kishte adaptuar në atë periudhë të mëvonshme, kur ai i bindi udhëheqësit e Perëndimit se ishte aleat i tyre kundër Moskës. E tërë jeta e tij është shtruar këtu për ekzaminim.

Tito ka qenë djalë fshatari me vetëm gjashtë vite shkollë dhe me zanat bravari. Kur shërbeu në Luftën e Parë Botërore, u zu rob nga rusët dhe pastaj u rekrutua nga bolshevikët. Duke u trajnuar në Moskë nga shërbimi inteligjent ushtarak, me gjasë kështu sugjerojnë autorët, punoi si agjent kohë pas kohe jashtë dhe brenda Jugosllavisë.

Në Moskë, në vitin 1935, ai tregoi talent për informator të shokëve të tij të ngushtë, të cilët u eliminuan nga skuadrat për ekzekutim. Kur u kthye në Jugosllavi, ai pa u vonuar e denoncoi rivalin e tij kryesor dhe e mori kontrollin e partisë komuniste të paorganizuar. Kur Hitleri e filloi blickkrigun kundër Jugosllavisë, në prill të vitit 1941, Tito nuk bëri asgjë për të përgatitur rezistencë anti-gjermane. E ndoqi vijën e Moskës pasi që Gjermania ishte aleat i Stalinin, e cila gjë ndryshoi vetëm kur Hitleri e invadoi Rusinë pas dhjetë javëve.

Autorët e kanë paraqitur mirë këtë poentë. Por, në paraqitjen e luftës në Jugosllavi, këta autorë në mënyrë të befasueshme i qëndrojnë afër tregimit tradicional të vetëlavdërimit komunist. Ata theksojnë se Tito mbledhi forca të mëdha, marshoi në distanca të gjata dhe nganjëherë zhvilloi beteja të rrepta me gjermanët. Por, nuk theksojnë se këto marshime kanë qenë tërheqje dhe se betejat e mëdha që i bënë partizanët e Titos kanë ndodhur vetëm nëse gjermanët dëshironin të sulmonin.

Për një libër polemik anti-Tito, kjo gjë tërheq disa goditje. Marrëveshja sekrete që Tito ua ofroi gjermanëve në vitin 1943 është lëmuar sikur të ishte brengë vetëm e ndërrimit të burgosurve të luftës. Por, ne kemi dëshmi të një oficeri të inteligjencës gjermane që është angazhuar në këtë rast dhe i cili thekson se Tito ka ofruar të bëhet kolaboracionist i Gjermanisë për t'i rezistuar zbarkimeve anglo-amerikane – ofertë tërësisht në pëlqim me planin strategjik të Titos pasi që ai frikësohej se aleatët do ta kthenin në pushtet qeverinë e vjetër rojaliste në Beograd.

Sërisht, Titos i vishen meritat për ndjekjen e gjermanëve në fund të luftës kur ata po e tërhiqnin ushtrinë nga Greqia dhe Maqedonia nëpër Jugosllavi. Dy

nga divizionet e tij, siç na thuhet, i sulmuan gjermanët që kalonin nëpër Kosovë. Unë e kam lexuar ditarin e komandantit gjerman (në arkivin e Uashingtonit) ku mezi përmenden sulmet e vogla partizane e lëre më ato të divizioneve. Në tërësi, 350 mijë gjermanë kaluan pa ndonjë pengesë. Tito nuk dëshironte ta harxhonte municionin kundër gjermanëve, të cilët edhe ashtu po largoheshin; ai ishte shumë i zënë duke provuar që të zaptonte copa të territorit jashtë kufijve të Jugosllavisë së vjetër.


Kjo na shpie matanë gjysmës së librit, në pikën kryesore: ambiciet e Titos, madje megalomane, të një udhëheqësi të pasluftës. Këtu janë disa detaje mbresëlënëse në lidhje me kontrollin e tij të rrjetit të agjentëve, veteranëve të luftës civile spanjolle dhe tjerëve; në fund të luftës komunistët e flaktë italianë ishin bërë gati që t'i merrnin qytetet kryesore duke shpresuar në invadimin jugosllav për ta marrë Venedikun. Kanë qenë këto ambicie, plus organizimi i një lufte tjetër me ndërmjetësues, Lufta Civile Greke, që e bindi Stalinin t'i ndërpriste marrëdhëniet më 1948.

Më tutje, autorët paraqesin mençurinë e Titos për rinovacion si burrështetas i 'painkuadruar' nga e cila përfitoi një ndihmë të madhe amerikane. Këputja me Moskën ka qenë shumë e

shkurtër; Hrushovi e miqësoi dhe së shpejti Tito u ndihmua nga të dy anët. Natyrisht që vjëlzimi i tij instinktiv ka qenë pro-komunist, kështu që ishte Perëndimi që u 'mashtroi'.

A kishte rëndësi kjo gjë? Autorët argumentojnë se në vazhdimësinë e tij të gjatë të strategjisë ndaj Mesdheut, Tito i ka shkaktuar dëme të mëdha Britanisë dhe Francës pasi që i ndihmoi Naserit në Egjipt (duke i dhënë dorë për Suezin) dhe rebelët në Algjeri. Këto informata që ofrohen këtu janë mbresëlënëse, por konkluzioni duket i tepruar shumë pasi që del se Tito kishte shkaktuar rënien e kolonializmit anglo-francez në Mesdhe. Dhe, ideja që Tito u bë 'guru' i Hrushovit për politikë të jashtme, duke e shndërruar atë në intervencionist të Botës së Tretë, është ekzagjerim edhe më i madh. Fuqia e këtij libri nuk qëndron në spekulime kaq grandioze, por në detajet e mprehta. Për fat të keq detajet kërkojnë mihje në mes të një mori emrash dhe akronimeve; proza, edhe pse e nxituar dhe e çuditshme, nuk është lehtë e lexueshme. Megjithatë, ata që këmbëngulin do të mësojnë shumë për mungesën e dëshmimeve standarde. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova shkatërroi Zvicrën

“Epoka e re”

PRIZREN, 19 KORRIK - Kosova ka nisur me fitore. “Dardanët” në Prizren kanë mundur Zvicrën me shifrat 76:49 (18:16, 23:8, 27:14, 8:11). Çereku i parë ishte kryesisht i barabartë, ku asnjëra nuk arrinte të shkëputej në epërsi, derisa përfundon 18:16. “Dardanët” ndezën motorët në periudhën e dytë. Me një lojë të

shpejtë filluan shkëputjen, duke shkuar në pushim me rezultat 41:24. Kosova nuk u ndal as në periodën e tretë, ku jo vetëm që ruajtën epërsinë, por edhe e thelloi, madje kishte epërsi deri në 31 pikë, 65:34, ndërsa rezultati pas 30 minutash ishte 68:38. “Dardanët” ruajtën epërsinë në dhjetë minutat e fundit dhe menaxhuan lojën, duke triumfuar bindshëm 76:49. Te Kosova u dalluan Dardan Berisha

me 20 pikë, Drilon Hajrizi me 14 pikë e 12 kërcime dhe Dominic Artis me 19 pikë e gjashtë asistime. Ndeshja e ardhshme për “Dardanët” do të jetë kundër Danimarkës në udhëtim më 26 korrik. Tri ditë më vonë janë mysafirë të Zvicrës, kurse kampanjën kualifikuese për Rrethin e Tretë për “Eurobasket 2025”, e përmbyllin me sfidën kundër Danimarkës më 5 gusht në Prizren.



Ballkani pëson humbje të thellë nga Ludogorets, eliminohet nga Liga e Kampionëve

“Epoka e re”

PRISHTINË, 19 KORRIK - Kampionia e Kosovës në futboll, Ballkani është eliminuar nga Liga e Kampionëve, pasi humbi ndeshjen kthyesë ndaj Ludogoretsit me rezultat 4-0. Skuadra kosovare e fitoi ndeshjen e parë me rezultat 2-0, prandaj edhe pritjet ishin më të mëdha, por të mërkurën në mbrëmje në Bullgari djelmohat e Ilir Dajës nuk e patën natën e tyre dhe është dashur të pajtohen me humbje. Tekpetey realizoi dy gola në fillim dhe mbarim të pjesës së parë për të barazuar rezultatin e



përgjithshëm 2-2. Në fillim të pjesës së dytë u prit reagimi i Ballkanit, por një lëshim nga mbrojtësi Bajram Jashanica bëri që vendasit të shënojnë golin e tretë nëpërmjet Tisseras. Ndërsa Caio Vidal e shfrytëzoi edhe një

gabim të Ballkanit për të shënuar për rezultatin 4-0. Ballkani tani do të vazhdojë garimin në raundin e dytë kualifikues në Ligën e Konferencës, aty ku do të synojë të arrijë grupet, ashtu siç bëri edicionin e kaluar.

SHKURT

Kryetari Ferati nënshkruan kontratat për subvencionimin e klubeve sportive dhe OJQ-ve në Istog

Kryetari i komunës së Istogut, Ilir Ferati, bashkë me përfaqësuesit e organizatave dhe klubeve sportive të komunës së Istogut, ka nënshkruar kontratat për subvencionimin e këtyre klubeve për t’i zhvilluar aktivitetet e tyre. “Qeverisja jonë do të përkujdeset që rinia, sporti dhe kultura të kenë mbështetje të vazhdueshme për aktivitetet kulturore dhe sportive”, ka thënë kryetari Ferati, i cili i ka uruar përfituesit e subvencioneve edhe për suksese të reja gjatë viteve të ardhshme. Përfaqësuesit e organizatave dhe klubeve sportive e kanë falënderuar kryetarin Ferati për përkrahjen, duke theksuar se kjo është edhe një ndihmesë shtesë që po u bëhet klubeve sportive dhe OJQ-ve në Istog.

Ende s’ka marrëveshje në mes të Galatasaryt dhe Norwichit për Rashicën

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Milot Rashica, ende nuk ka vendosur për të ardhmen e tij dhe ende është duke i vazhduar pushimet. Galatasary po planifikon ta blejë anësorin “dardan”, por ende nuk ka arritur marrëveshje me klubin anglez Norwich City. Këto “telashe” i konfirmon edhe trajneri Okan Buruk. “Kërkesa jonë për transferimin e Milot Rashicës dhe negociatat janë duke vazhduar. Ka dallim mes ofertës sonë dhe klubit anglez. Nëse ka zgjidhje, duam ta shtojmë në skuadër”, ka thënë Buruk.

EHF-ja falënderon FHK-në për organizimin e Kampionatit Evropian U19

Presidenti i Federatës Evropiane të Hendbollit, Michael Wiederer, dhe sekretari i përgjithshëm i EHF-së, Martin Hausleitner, i kanë dërguar të mërkurën letër presidentit të Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini dhe sekretarit gjeneral Izet Gjinovci. Drejtuesit e EHF-së e kanë falënderuar FHK-në dhe drejtuesit e saj për organizimin e Kampionatit Evropian U19 për hendbolliste. Është vlerësuar përkushtimi i drejtuesve të FHK-së dhe stafit lokal për organizimin e shkëlqyer të Evropianit. Organizimi është vlerësuar shumë profesional, ndërsa pritja për delegacionet shumë e mirë. FHK-ja është falënderuar për ngjarjen shumë të suksesshme. Kështu vlerësimet për FHK-në vazhdojnë, ndërsa së shpejti pritet edhe konfirmimi i ngjarjeve të tjera që do të organizohen nga Federata e Kosovës.

‘Gjeneral Munishi dhe Brigada e Ushtarëve të Rinj të FC Ferizajt’

FC Ferizaj po i vazhdon përgatitjet intensive në Mavrovë të Maqedonisë së Veriut nën urdhrat e trajnerit Ismet Munishi. Ferizajasit e kanë bërë një postim në

rrejetet sociale ku shihet trajneri i njohur kosovar së bashku me disa lojtarë të rinj, të cilët janë produkt i shkollës së futbollit të këtij klubi. “Gjeneral Munishi dhe

Brigada e Ushtarëve të Rinj të FC Ferizajt. Secili më i mirë se tjetri, e secili me potencial të pafund dhe të ardhme të ndritur. Ismet Munishi i beson projektit me lojtarë të

rinj. E kaluara e tij është dëshmia se shumë lojtarë përmes këtij trajneri kanë dalë në futbollin evropian, duke i prekur majat e karrierës futbollistike”, shkruan në

postimin e Ferizajt. Munishi e mori në dorë këtë ekip me synimin që ta rikthejë në Superligë menjëherë pasi ta kalojë një sezon në Ligën e Parë.

Guri Hana i bashkohet KF Shkëndija

PRISHTINË, 19 KORRIK - KF Shkëndija ka njoftuar se është përforcuar me futbollistin Guri Hana. Ky i fundit ka përvojë mjaft të madhe, pasi në edicionin e fundit ishte pjesë e skuadrës së Trepçës '89 në Superligën e Kosovës në futboll. "Kemi

kënaqësinë ta prezantojmë futbollistin e ri që i bashkohet klubit tonë, qendërmbrojtësin Guri Hana. Guri vjen nga KF Trepça '89 FC me të cilën u paraqit në Albi Mall Superligë në edicionin që lamë pas", thuhet në njoftimin e

Shkëndijës. Guri Hana në të kaluarën ka qenë pjesë e 2 Korrikut, Ramiz Sadikut dhe Besës në Superligë. "Me Gurin e shokët e tij, mbrojtja bëhet guri", ka shkruar KF Shkëndija në faqen zyrtare në "Facebook". Ndërsa futbollisti Hana është

shprehur i kënaqur që iu bashkua kësaj skuadre: "Jam shumë i lumtur që iu bashkova projektit të KF Shkëndija. E njoh shumicën e grupit e stafit, andaj besoj se shpejt do të adaptohem e do t'i arrijmë objektivat e klubit".



Lamtumira prekëse e Onanas nga Interi: Një pjesë e zemrës sime është e trishtuar

MILANO, 19 KORRIK - Ish-portieri i Interit, Andre Onana, foli për "Gazzetta dello Sport" për ndjenjat e tij, tani që po largohet nga klubi zikaltër për t'u bashkuar me Manchester Unitedin: "Një pjesë e zemrës sime është e trishtuar. Të largohem nga Interi do të thotë të largohem nga një familje, jo një skuadër normale. E kuptova që të jesh me Interin është një mënyrë për të qenë në botë, për të jetuar jetën...". Portieri kamerunas më pas u ndal në të kaluarën e tij tek Interi: "Po flas vërtet për magjinë, një shkëndijë me mjedisin. E di që do të jem në gjendje të udhëtoj nëpër botë, por do të jetë e vështirë të gjej tifozë të tillë dhe një 'kurba' si ajo e Interit. 'San Siro' dhe zikaltrit më dhanë emocione unike, që nuk do t'i harroj kurrë gjatë gjithë jetës sime. Në disa ndeshje ishim një: kisha ndjesinë që nuk luaja me 11, por me 80 000 lojtarë. Aftësia për ta përjetuar nga brenda ishte një privilegj, që ma ka dhënë futbolla dhe jeta. Gjëja e rëndësishme është të jesh i singertë dhe gjithmonë t'u



thuash njerëzve të vërtetën", ka shtuar ai. "Unë jam një person që dua gjithmonë sfida të reja. Të luash në Premierë Ligë dhe për një klub si Manchester Unitedi është e parëzistueshme. Të gjitha palët donin që kjo të ndodhte... Ajo që ka rëndësi është se nëse do të kisha qëndruar, do të isha po aq i lumtur, sepse nuk kam pasur kurrë probleme tek Interi. Në të vërtetë, në Milano lindi një magji që është

pothuajse e vështirë të shpjegohet", ka deklaruar Onana. Kamerunasi largohet nga zikaltrit, por mes deklaratave të tjera nuk ia mbyll derën një rikthimi hipotetik: "Kush e di, jeta është e paparashikueshme, ndoshta një ditë do të kthehem edhe unë... Dhe nëse kjo ndodhë ndonjëherë, jam i sigurt se njerëzit do të më përqafojnë si tani, sepse më njohin".

Edhe Mercedesi heq dorë nga ky sezon, mendon për sezonin e ri

STUTTIGART, 19 KORRIK - Pas Ferrarit edhe Mercedesi po mendon që tani për vitin 2024. Skuadra gjermane e sheh që nuk ka asnjë mundësi për të qenë protagoniste këtë sezon të Formulës 1. Madje paraqitjet e saj kanë rënë disi në garat e fundit, duke detyruar drejtorin sportiv të garave Toto Wolff të mendojë më shumë për të ardhmen. "Nuk kemi zgjidhje tjetër. Këto vende në renditje nuk janë objektivi ynë. Ne dëshirojmë të jemi në majë dhe ta fitojmë kampionatin. Kjo gjë nuk do të ndodhë këtë vit, ndaj duhet të shohim nga sezonin 2024, duke shfrytëzuar garat e ardhshme për të mësuar se si ta përmirësojmë makinën aktuale", ka thënë Toto Wolff. "Synojmë që të kemi modifikimet e duhura për makinën tonë të ardhshme. Shumë skuadra do të fokusohen tek e ardhmja edhe pse jemi ende



në mesin e sezonit. Kjo do të thotë se do të humbasim mjaft terren nga makina aktuale, kryesisht për sa i përket shpejtësisë", u shpreh menaxheri i njohur. "Do të ketë disa modifikime të makina aktuale që do të aplikohen edhe tek ajo e vitit 2024. Ne duam të

investojmë pikërisht te këto modifikime afatgjata. Në garat e ardhshme do të kemi mjaft rivalitet për zonën e pikëve mes makinave dhe do të jenë të rejtat që do të sjellin makinat ato që do ta bëjnë dallimin", ka deklaruar Wolff.

SHKURT

Felix: Ekipi i zemrës time është Barça

Në një intervistë për gazetarin Fabrizio Romano, ylli i Atletico Madridit, Joao Felix, ka treguar se klubi i tij i zemrës është Barcelona. "Dua që të luaj për Barçën. Barcelona ka qenë gjithmonë zgjedhja ime e parë. Që nga fëmijëria e kam pasur ëndërr Barcelonën. Nëse ndodh kjo, do të realizohej ëndërra ime", ka thënë Felix. Portugezi ishte transferuar në vitin 2019 nga Benfica tek Atletico Madridi për 127 milionë euro, pastaj në janar të këtij viti u huazua te Chelsea ku nuk tregoi formë të mirë dhe në qershor u kthye përsëri në kryeqytetin spanjoll.

Mendy shpallet i pafajshëm, nënshkruan për Lorientin

Benjamin Mendy do të rikthehet në fushën e blertë pasi u shpall i pafajshëm për disa raste të përdhunimeve të ndodhura në vitet e fundit. Mbrojtësi i Francës, kampion bote në vitin 2018, ka nënshkruar një kontratë dyvjeçare me FC Lorient, një klub i Ligës 1. Lajmi është bërë me dije nga vetë klubi përmes një njoftimi në rrjetet sociale. Kështu ai rikthehet në Francë, pasi ka luajtur me ekipe si Le Havre, Monaco dhe Marseille. Së fundmi ai ishte pjesë e ekipit të Manchester Cityt.

Aubameyangu transferohet te Marseille

Sulmuesi Pierre Emerick Aubameyang ka pranuar të transferohet në Francë me ekipin e Marseilles. Sulmuesi gabonez ka pranuar një kontratë trevjeçare deri në qershor të vitit 2026. Chelsea do ta lërë të largohet me parametra zero dhe sot ai pritet të mbërrijë në kampin francez për t'i kryer vizitat mjekësore. Një tjetër sulmues largohet nga Chelsea dhe ky është një lajm i mirë për Brojën, pasi pritet të ketë më shumë hapësira te klubi anglez.

Atletico në bisedime me PSG-në për Verrattin

Mesfushori i Paris Saint-Germain, Marco Verratti, ka përfunduar në listën e dëshirave të Atletico Madridit dhe trajnerit Diego Simeone, i cili e do italianin në "Wanda Metropolitano" këtë verë. Atletico ka nënshkruar deri tash me Javi Galan, Caglar Soyuncu, Cesar Azpilicueta dhe Santiago Mourino, kurse tash synon edhe mesfushorin italian. Marco Verratti admirohet masivisht nga Atletico dhe ai po ëndërron të nënshkruajë këtë verë me yllin italian. Sipas gazetarit të "L'Equipe", Loic Tanzi, drejtuesit e Atletico kanë nisur negociatat paraprake me Paris Saint-Germain për një nënshkrim të mundshëm të Verrattit. Asnjë ofertë nuk është bërë ende, por në varësi të rezultatit të bisedimeve, një ofertë mund të bëhet në dy javët e ardhshme. Çmimi i futbollistit është 80 milionë euro, një shumë jo e vogël për t'u paguar nga Atletico.

Buffoni mund të pensionohet nga futbolla

Portieri i njohur Gianluigi Buffon së shpejti mund ta shpallë pensionimin e tij. Sipas gazetarit Gianluca di

Marzio në faqen e tij të internetit, futbollisti 45-vjeçar mund të refuzojë një ofertë nga Arabia Saudite dhe t'i japë fund

futbollit. Që nga viti 2021 Buffon luan për Parma, ku dikur hodhi hapat e parë në futboll. Në vitet 2001-2018 dhe

2019-2021 Gianluigi mbrojt portën e Juventusit. Mes këtyre periudhave portieri kaloi një sezon te PSG-ja. Gjatë karrierës

së tij, Gianluigi Buffon fitoi shumë trofe. Në vitin 2006 portieri u bë kampion bote si pjesë e kombëtares italiane.



Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" SHA. shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

I. Teknik/e i/e IT-së, dy (2)

Departamenti i Teknologjisë Informative

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Instalimi, konfigurimi, mirëmbajtja e rrjetit dhe pajisjeve të IT-së (PC, Printer, Fotokopje, etj.);
- Zhvillimi i Software dhe mirëmbajtja e faqes zyrtare;
- Mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemeve të reja që mund të zhvillohen brenda IT-së për nevojat e Ndërmarrjes;
- Ofrimi i ndihmës për punëtorët e ndërmarrjes në rast të përdorimit të pajisjeve dhe programeve të IT-së;
- Ndihmon në futjen e shënimeve në sisteme të ndryshme si faqe zyrtare dhe sisteme tjera;
- Intervenon sipas kërkesave të zyrtarëve në të gjitha rastet për evitimin e prishjeve teknike në pajisjet kompjuterike.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollim universitar;
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Certifikatë për TI;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

Procedura e Konkursimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

II. Zyrtar/e i/e Komunikimit Publik, një (1)

Divizioni i Komunikimit Publik

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Krijon, zhvillon dhe implementon kampanjat e marketingut me qëllim të promovimit të shërbimeve të Ndërmarrjes;
- Koordinon aktivitetet/eventet promovuese brenda Ndërmarrjes;
- Implementon aktivitetet promovuese në terren dhe realizon takimet me kompani dhe institucione të ndryshme;
- Menaxhon aktivisht prezencën e Ndërmarrjes në mediat sociale;
- Analizon prezencën e shërbimeve në treg (konkurrencën, çmimet, promocionet, marketingun) dhe përcjellë aktivitetin e promocioneve, analizon dhe bën matjen e efekteve të shetjes/promovimit para, gjatë si dhe pas promovimit;
- Kryen edhe detyra tjera që kanë të bëjnë me promovimin e Ndërmarrjes.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi universitar;
- Së paku një (1) vit përvojë pune, preferohet të jetë në fushën e marketingut;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;

- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

Procedura e Konkursimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

III. Mirëmbajtës/e i/e objektit, një (1)

Departamenti i Administratës

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Pastrimin e objektit të Ndërmarrjes;
- Mirëmbajtja e mjeteve të punës që i shfrytëzon;
- Kujdeset për higjienën;
- Kryen edhe punë të tjera me kërkesë të mbikëqyrësit.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Diploma e shkollës fillore;
- Preferohet të ketë përvojë pune.

Procedura e Konkursimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit.

Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

IV. Zyrtar/e për Auditim, një (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Aktivitetet e zyrës së auditimit rreth çështjeve të brendshme të Ndërmarrjes;
- Udhëheqjen dhe drejtimin e aktiviteteteve të auditimit të brendshëm;
- Auditimin e aktiviteteteve të Ndërmarrjes në tërësi;
- Zbaton të gjitha standardet e cilësisë të përcaktuara me doracakun e auditimit të regullsisë;
- Raportimin pranë Zyrtarit/es për Auditim të Brendshëm;
- Përbushjen e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Zyrtarit/es për Auditim të Brendshëm.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollim universitar në fushën e ekonomisë;
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Çertifikimi në auditim;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;

- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office).

Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

V. Zyrtar/e për Monitorim të Kontrollave, katër (4),

Departamenti i Operimeve, Divizioni i Parkingjeve të Hapura

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Monitorimin ditor të kontrollave të kryera nga kontrollorët në terren,
- Verifikimin e kontrollave në raport me pagesat,
- Raportimin pranë mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë dhe udhëheqësit për kontrollat e kryera,
- Kryerja e punëve tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë/udhëheqësit.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Diploma e shkollës së mesme, preferohet të ketë shkollim universitar;
- Preferohet të ketë përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office).

Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, që kanë përfunduar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave përkatëse.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën e Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A. rr. "Luan Haradinaj", p.n. Pallati i Rinisë (ish ASK), 10000, Prishtinë, Kosovë.

Aplikacioni merret në selinë e N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A. apo mund të shkarkohet në faqen zyrtare www.prishtinaparking.net. Kandidatët të cilët aplikojnë, duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data 20.07.2023 deri më 03.08.2023, në ora 16:00.



**Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**



Na temelju odredaba članka 8. Zakona br. 03/L-212 o radu i članak 4. Administrativnog uputstva (MPMS) br. 07/2017 za regulisanje tenderskih postupaka u javnom sektoru, lokalno javno poduzeće "Prishtina Parking" SH.A. najavi ovo:

JAVNI NATJEČAJ

I. Informatički tehničar, dva (2)

Odjel za informacijske tehnologije

Dužnosti i odgovornosti:

- Instalacija, konfiguracija, održavanje mrežne i IT opreme (PC, Printer, Fotokopirni uređaj, itd.);
- Razvoj softvera i održavanje službene web stranice;
- Održavanje i razvoj novih sustava koji se mogu razvijati unutar IT-a za potrebe Poduzeća;
- Pružanje pomoći radnicima poduzeća u slučaju korištenja informatičke opreme i programa;
- Pomaže pri unosu bilješki u različite sustave kao što su službena web stranica i drugi sustavi;
- Intervenira prema zahtjevima službenih osoba u svim slučajevima kako bi se izbjegli tehnički kvarovi na računalnoj opremi.

Osposobljenost i stručna sprema

- Sveučilišno obrazovanje;
- Najmanje jedna (1) godina radnog iskustva;
- Certifikat za IT;
- Tečajevi i druga usavršavanja tijekom profesionalne karijere;
- Imati dobre komunikacijske i pregovaračke vještine;
- Dobro poznavanje stranih jezika u pisanom i govornom obliku;
- Poznavanje rada na računalu (Microsoft Office).

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikacija;
- CV;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjereni kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i uvjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK-a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice;
- Motivacijsko pismo.

Razdoblje ugovora: šest (6) mjeseci probnog rada, iskoristite mogućnost produženja ugovora u neorednom roku, ukoliko imate pozitivne ocjene o radu.

II. Službenik za javno komuniciranje, jedan (1)

Odjel za javno komuniciranje

Dužnosti i odgovornosti:

- Kreira, razvija i provodi marketinške kampanje u svrhu promicanja usluga Društva;
- Koordinira promotivne aktivnosti/događaje unutar Poduzeća;
- Provodi promotivne aktivnosti na terenu i održava sastanke s različitim tvrtkama i institucijama;
- Aktivno upravlja prisutnošću Poduzeća na društvenim medijima;
- Analizira prisutnost usluga na tržištu (konkurencija, cijene, promocije, marketing) i prati aktivnost promocije, analizira i mjeri učinke prodaje/promocije prije, tijekom i nakon promocije;
- Obavlja i druge poslove vezane uz promicanje Poduzeća.

Osposobljenost i stručna sprema

- Sveučilišno obrazovanje;
- Najmanje jedna (1) godina radnog iskustva, poželjno na poslovima marketinga;
- Imati dobre komunikacijske i pregovaračke vještine;
- Tečajevi i druga usavršavanja tijekom profesionalne karijere;
- Dobro poznavanje stranih jezika u pisanom i govornom obliku;
- Poznavanje rada na računalu (Microsoft Office).

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikacija;
- CV;

- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i uvjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK-a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice;
- Motivacijsko pismo.

Ugovor o radu: šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost nastavka ugovora na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.

III. Održavanje objekta, jedan (1)

Odjel za upravu

Dužnosti i odgovornosti

- Čišćenje objekta Poduzeća;
- Održavanje korištenih radnih alata;
- Njega higijene;
- Obavlja i druge poslove po nalogu rukovoditelja.

Osposobljenost i stručna sprema

- Diploma osnovne škole;
- Radno iskustvo je poželjno.

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikacija;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i uvjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK-a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice.

Ugovor o radu na određeno vrijeme: šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost nastavka ugovora na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.

IV. Službenik za reviziju, jedan (1)

Dužnosti i odgovornosti:

- Aktivnosti ureda za reviziju u vezi s internim pitanjima Poduzeća;
- Vođenje i upravljanje aktivnostima unutarnje revizije;
- Revizija aktivnosti Poduzeća u cjelini;
- Provodi sve standarde kvalitete definirane priručnikom za reviziju pravilnosti;
- Izvještavanje službeniku za unutarnju reviziju;
- Obavljanje drugih zadataka koje odredi službenik unutarnje revizije.

Osposobljenost i stručna sprema

- Sveučilišno obrazovanje u području ekonomije;
- Najmanje jedna (1) godina radnog iskustva;
- Ovjera revizije;
- Imati dobre komunikacijske i pregovaračke vještine;
- Dobro poznavanje stranih jezika u pisanom i govornom obliku;
- Poznavanje rada na računalu (Microsoft Office).

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikacija;
- CV;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i uvjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK-a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice;

- Motivacijsko pismo.

Ugovor o radu: šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost nastavka ugovora na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.

V. Službenik za kontrolu i praćenje, četiri (4)

Operativni odjel, Odjel za otvorena parkirališta

Dužnosti i odgovornosti:

- Dnevno praćenje kontrola koje provode kontrolori na terenu,
- Provjera čekova u vezi s uplatama,
- Izvještavanje neposrednog nadređenog i voditelja o izvršenim kontrolama,
- Obavljanje drugih poslova na zahtjev neposrednog nadređenog/voditelja.

Osposobljenost i stručna sprema

- SSS, poželjno VSS;
- Poželjno je radno iskustvo;
- Tečajevi i druga usavršavanja tijekom profesionalne karijere;
- Imati dobre komunikacijske i pregovaračke vještine;
- Dobro poznavanje stranih jezika u pisanom i govornom obliku;
- Poznavanje rada na računalu (Microsoft Office).

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikacija;
- CV;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i uvjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK-a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice;
- Motivacijsko pismo.

Ugovor o radu: šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost nastavka ugovora na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.

NAČIN PRIMJENE:

Pravo prijave imaju svi punoljetni državljani Republike Kosovo koji su završili odgovarajuće obrazovanje i imaju stručnu sposobnost za obavljanje odgovarajućih dužnosti.

Ispunjeni dokumenti moraju se dostaviti na adresu lokalnog javnog poduzeća "Prishtina Parking" SH, ul. "Luan Haradinaj", p.n. Palata mladosti (bivši ASK), 10000, Priština, Kosovo.

Prijava se zaprima u sjedištu N.P.L. "Prishtina Parking" dd. ili se može preuzeti sa službene stranice www.prishtinaparking.net. Kandidati koji se prijavljuju moraju unijeti točnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Samo odabrani kandidati bit će pozvani na razgovor.

Prijave dostavljene nakon roka ne prihvaćaju se, dok se nepotpune prijave odbacuju.

Natječaj je otvoren u trajanju od 15 (petnaest) dana od 20.07.2023. do 03.08.2023., u 16:00 sati.



ROYAL CROWN;
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L